



Buletin informativ

Zhvillimet kryesore në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara • Korrik - Dhjetor 2019

Buletini u realizua me fonde të Qeverisë Suedeze nëpërmjet bashkëpunimit me Civil Rights Defenders.

U MIRATUAN GJETJET PËRFUNDIMTARE TË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR SHQIPËRINË

Me datë 16 Shtator 2019, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) nxorri përfundimet mbi zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) nga ana e shtetit Shqiptar. Komiteti ndër tjetër tjera përgëzoi miratimin e Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara, miratimin e Planit të Veprimit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016- 2020, dhe miratimin e

Urdhrit Nr. 195 për Profilin e Mësuesit Mbështetës. Ndërkohë, Komiteti shprehu shqetësimin e tij në lidhje: rishikimin e pamjaftueshëm të përputhjes së legjislacionit me KDKPAK mungesën e një konsultimi efektiv me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, sidomos në lidhje me vlerësimin bio-psiko-social, mungesën e një kuptimi të harmonizuar të aftësisë së kufizuar, mungesën e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, dhe përdorimin e gjuhës fyese në ligjet, politikat shqiptare,

e në përgjithësi në diskursin publik. Komiteti i rekomandon, ndër të tjera, shtetit Shqiptar që të përdorë qasjen e të drejtave të njeriut ndaj personave me aftësi të kufizuara, të rishikojë legjislacionin dhe politikat, sidomos reformën e vlerësimit, dhe eliminimin e përdorimit të gjuhës fyese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Më shumë informacion mbi gjetjet përfundimtare të komitetit gjeni tek: <https://www.ohchr.org/EN/Countries/ENACARegion/Pages/ALIndex.aspx>

VENDIME TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

VENDIMI I

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) me Vendimin Nr. 143, datë 10/10/2019 konstatoi diskriminim për shkak të "aftësisë së kufizuar", të Z. Kastriot Marku, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT), si pasojë e mos garantimit të trajtimit me sasinë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor VIII. Gjithashtu, KMD konstatoi diskriminim e Z. Kastriot Marku, për shkak të "vendbanimit", nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si pasojë e mosfrimit të shërbimit mjekësor

dhe medikamentit Faktor në Spitalin Rajonal të Lezhës, pranë vendbanimit të tij.

KMD u vu në lëvizje nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara pas kërkesës që i drejtoi fondacionit Z. Kastriot Marku, person me aftësi të kufizuara i cili vuan nga Hemofilia e rëndë, e tipit A.

Mosdhënia e medikamentit Faktor VIII, ose dhënia në sasi të pamjaftueshme, të ndryshme nga ato të rekomanduara nga mjeku hematolog, ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të Z. Marku.

Z. Marku gjithashtu i duhet të udhëtojë disa herë në muaj drejt Tiranës, për të tërhequr

medikamentin Faktor VIII, ndërkohë që çdo herë që udhëton përballet me riskun e dëmtimeve dhe hemorragjive të brendshme dhe të jashtme. Udhëtimet janë të papërballueshme nga ankuesi, jo vetëm për sa i përket lodhjes dhe riskut për të pësuar dëmtime, por edhe shpenzimeve, që ai duhet të mbulojë çdo herë që udhëton për në Tiranë. Një gjë e tillë, ka pasur gjithashtu ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe buxhetin e tij familjar.

Ky vendim duhet të shtyjë institucionet të marrin masa të menjëhershme për sigurimin e medikamenteve të nevojshme afër pacientëve.

VENDIMI II

Me vendimin Nr. 119, datë 09/09/2019 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi diskriminimin e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Durrës dhe nga operatori i shërbimit urban qytetas Maren Bus sh.p.k.

Komisioneri urdhëroi që të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Durrës, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, në automjetet e shërbimit urban qytetas. Shërbimi urban qytetas është një shërbim publik, i cili, i cili menaxhohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe në rastin konkret nga Bashkia Durrës.

Detyrimi për të monitoruar dhe

kontrolluar zbatimin e parashikimeve të akteve të sipërpërmendura dhe përcaktimeve në kontratat e shërbimeve ka qenë detyrim i Bashkisë Durrës, e cila ka gjithashtu tagrin për të liçencuar operatorët e shërbimit urban¹ dhe për të marrë masa ndaj tyre në rast mospërbushje të detyrimeve ligjore dhe atyre kontraktore. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Durrës nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos- ofrimit të

¹ Shih Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit".

lehtësirave në transport për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se ky institucion nuk i ka kryer detyrimet e tij, duke diskriminuar personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë për shkak të aftësisë së kufizuar.

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve- Dega Qarku Durrës, përmes kryetares, kontaktoi Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili dha asistencën teknike për të përpiluar ankesën për diskriminim kundër bashkisë së Durrësit dhe operatorëve urban.

Për këtë rast u ofrua ndihma ligjore nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve- Dega Qarku Durrës.

REFORMA E VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Këshilli i Ministrave miratoi dokumentin politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij". Ky dokument lidhet me qëllimin strategjik të SKZHI "Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore" dhe qëllimin politik 4.6.2 "Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes vlerësimit bio-psikosocial, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke kombinuar skemën e pagesës Cash me shërbime të integruara, për të aritur integrimin e tyre social dhe ekonomik". Disa nga objektivat e kësaj reforme janë:

1. Zbatimi i sistemit të ri të vlerësimit sipas "modelit social" dhe ulja e përqindjes së përfituesve pa aftësi të kufizuar;
2. Rritja e transparencës së skemës përmes krijimit të regjistrit elektronik: fillimisht nëpërmjet pushteteve vendore në qarqet pilote, të cilat do të zbatojnë procedurat që lidhen me skemën e paaftësisë përmes këtij regjistri;
3. Krijimi i një sistemi të integruar të shërbimeve që kombinon shërbimet e kujdesit shoqëror me pagesat në para cash: personave me aftësi të kufizuar do tu ofrohet një paketë e integruar shërbimesh; dhe krijimi dhe forcimi i mekanizmit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në nivel qendror dhe vendor: prodhimi i raporteve tremujore të skemës së performancës, vlerësimit të profilit të riskut dhe zbulimit të

mashtimeve, për hartuesit e politikave. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara me një grup organizatash të personave me aftësi të kufizuara përgatiti disa rekomandime dhe zhvilloi një takim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për reformën e vlerësimit. Ndërkohë që organizatat shprehën vlerësimin për risitë që sjell reforma, sidomos kriteret e reja të vlerësimit të cilat do të identifikojnë gjitha nevojat e do të orientojnë gjithë ndërhyrjet e duhura; rritjen e transparencës përmes ngritjes së regjistrit elektronik, rritjen në përgjithësi të efijencës së administrimit të skemës së vlerësimit, si nga pikëpamja e menaxhimit administrativ, ashtu edhe procedural, ato shprehën një sërë shqetësimesh.

Disa nga shqetësimet kryesore që përcolli ky grup, dhe të cilat u morën në konsideratë nga Ministria pjesërisht kishin të bënin me mosndërhyrjen në nivelin aktual të pagesës për aftësinë e kufizuara për personat me aftësi të kufizuara të shkallës së lehtë dhe të moderuar, mosuljen e nivelit të pagesës për aftësinë e kufizuar, për fëmijët me aftësi të kufizuara në 75% të pagesës që jepet për të rriturit me aftësi të kufizuara, por kjo pagesë të jetë e barabartë me atë që jepet për të rriturit me aftësi të kufizuara. Ajo është pagesë që jepet për kosto që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe nuk ka lidhje me grupmoshën; ndryshimi i qasjes dhe trajtimit financiar për ndihmësin personal dhe interpretin e gjuhës së shenjave dhe mënyra e përcaktimit të

pagesës për ofrimin e këtij shërbimi dhe një çështje tejet të rëndësishme, atë që pilotimi i reformës të realizohet paralelisht me krijimin/ofrimin e shërbimeve të parashikuara në shportën e shërbimeve. Më shumë mbi dokumentin gjeni:

<http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Policy-Dokument-Template-MIN-e-Shendetesise-15.02.2019.docx>

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) është një organizatë shqiptare jofitimprurëse, themeluar nga OXFAM GB në vitin 1994. Programet e FSHDPAK, synojnë të rrisin shanset e personave me aftësi të kufizuara për t'u integruar në jetën sociale dhe ekonomike të vendit, përmes respektimit dhe mbrojtjes të së drejtave të tyre. Që nga krijimi i tij, FSHDPAK ka funksionuar si qendër koordinimi për ndërmarrjen e nismave më madhore në ndikim të përmirësimit të cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Misioni i FSHDPAK është promovimi i shanseve të barabarta dhe mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara me synim përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe për familjet e tyre. Për të përmbushur misionin tonë, ne punojmë së bashku me dhe pa aftësi të kufizuara. Mbeshtetja e vazhdueshme që ne kemi nga organizata, donatorë, institucione shtetërore, na ndihmon të përmirësojmë punën tonë, të jemi sa më pranë nevojave urgjente të klientëve tanë dhe komuniteteve për të cilat ne punojmë.